



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR VITIN 2024

| Nr. Rendor | Data e regjistrimit të kërkesës | Objekti | Data e kthimit të përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesës | Tarifa |
|-------------------|----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|---------------|
| 1. | 23.01.2024 | Kërkesë për informacion në lidhje me aksesueshmërinë e personave në institucionet e drejtësisë në përputhje me parashikimet e Konventës për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara të ratifikuar me ligjin nr. 108-2012 dhe sipas ligjit nr.93/2014 “ Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e | 02.02.2024 | Në përgjigje të shkresës suaj, ardhur më 25.01.2024, me nr.140 prot. nga ana jonë, drejtuar Kryetares së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, zonja Holta Zaçaj, ju informojmë se ndërtesa, ku aktualisht ushtron funksionet e saj jo vetëm Gjykata Kushtetuese, por edhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), është ndërtuar në vitin 1953 dhe | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| | | <p>personave me aftësi të kufizuara”.</p> <p>Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● A gjenden në Gjykatën Kushtetuese parkime të veçanta për personat me aftësi të kufizuar, të krijuara dhe të rezervuara posaçërisht për ta? ● A paraqitet e lehtë qasja në hyrjen e institucionit për personat me aftësi të kufizuar si p.sh. rampë për persona me aftësi të kufizuar në lëvizje ose për personat me karrocë me rrota? ● A është madhësia e dyerve hyrëse në institucionin dhe në salla gjyqësore e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuar në ecje? ● A janë shkrimet dalluese në hyrje të institucionit tuaj në madhësi të konsiderueshme për të garantuar shikimin nga personat me shikim të pjesshëm? | | <p>është shpallur <i>monument kulture i kategorisë II</i>, me urdhrin nr. 122,</p> <p>datë 05.03.2007, të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për shpallje monument kulture të kategorisë së dytë të ndërtesave në aksin kryesor të qendrës historike të qytetit të Tiranës”. Në këto kushte, në lidhje me pyetjet tuaja, ju sqarojmë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Pranë institucionit tonë nuk ka parkime të veçanta për personat me aftësi të kufizuar, të krijuara dhe rezervuara posaçërisht për ta. ● Hyrja e Gjykatës Kushtetuese nuk ofron rampë për personat me aftësi të kufizuar në lëvizje ose për personat me karrocë me rrota. ● Madhësia e dyerve hyrëse në institucion është e përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara në ecje. ● Shkrimet dalluese në hyrje të Gjykatës Kushtetuese janë të një | | |
|--|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

| | | | | | | |
|-----------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| | | <ul style="list-style-type: none"> ● A ka shkrime në gjuhën braille për personat me verbëri të plotë në hyrje të institucionit? ● A ka tualete të destinuara për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara në brendësi të institucionit? ● A ka ashensorë në brendësi të institucionit që të mundësojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar nga kati në kat? | | <p>madhësie të konsiderusheme për të garantuar shikimin nga personat me një shikim të pjesshëm por nuk ka</p> <p>shkrime me gjuhën braille për personat me verbëri të plotë.</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjithashtu nuk ka tualete të destinuara për përdorim nga personat me aftësi të kufizuar në brendësi të institucionit. | | |
| 2. | 19.02.2024 | <p>Kërkesë për informacion për çështjen me objekt: <i>Deklarimi i papajtueshëm me Kushtetutën të Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Migracionit” dhe ndalimi i ratifikimit të tij nga</i></p> | 21 .02.2024 | <p>Në vijim të kërkesës suaj, Gjykata Kushtetuese njofton palët për datën dhe orën e shpalljes së vendimit përfundimtar nëpërmjet postës elektronike, nëse ata kanë paraqitur adresën e saj, ose me shkresë, sipas parashikimeve të nenit 42, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, të ndryshuar.</p> <p>Për sa më sipër, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse, ju</p> | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| | | <p><i>Kuvendi. Pezullimi i procedurave për ratifikimin e Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Migracionit”</i>”, për t’u njohur me praktikën e njoftimit të palëve në gjykim, para zbardhjes së një vendimi; vënien në dispozicion të provave që vërtetojnë orarin e lajmërimit të palëve nga ana e Gjykatës Kushtetuese si dhe dhënien e një përgjigje në lidhje me pyetjen nëse i cënohet besueshmëria Gjykatës kur në një mbledhje partiake zbulohet oraret e publikimit të vendimeve duke lënë hapësira të forta dyshimi për politizimin e çëshjes.</p> | | <p>informojmë se Gjykata Kushtetuese ka njoftuar palët në proces për datën dhe orën e shpalljes së vendimit përfundimtar me e-mail-in e datës 19.02.2024, ora 14:11 (këtu bashkëlidhur).</p> | | |
|--|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|

| | | | | | | |
|----|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|
| 3. | 29.03.2024 | <p>Kërkesë për informacion në lidhje me fillimet e afateve në Gjykatën Kushtetuese. Më konkretisht, nëse Gjykata pranon vetëm zënien e afatit pa një kërkesë të plotësuar, nëse ka praktikë që duhet të marrë një vërtetim në Gjykatën e Lartë dhe afati 4 mujor fillon nga momenti i zbardhjes së njoftimit dhe botimit në faqen e Gjykatës, apo nga momenti që njoftohet në rrugë elektronike vendimi nga ana e Gjykatës së Lartë.</p> | 4.04.2024 | <p>Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju bëjmë me dije se bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-mujaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës.</p> <p>Theksojmë, se Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka pranuar se, në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit.</p> <p>Për më shumë, ju lutem referojuni vendimit përfundimtar nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese, të cilin e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.</p> | E plotë | Nuk ka |
|----|------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|

| | | | | | | |
|----|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| 4. | 24.04.2024 | <p>Kërkesë për koment në lidhje me moszbatimin në të paktën 2 raste të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese; për deklaratat e aktorëve politikë të cilët janë shprehur se Kuvendi nuk mund të detyrohet të votojë në një formë të caktuar (rasti Xhaçka) dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të detyrojë Kuvendin të arrijë konsensus (rasti i votës së emigrantëve); si dhe nëse ka pasoja/penalite për ata që “injorojnë” vendimet e Gjykatës Kushtetuese?</p> | 25.04.2024 | <p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju lutem mbani parasysh se Gjykata Kushtetuese nuk komenton për çështje për të cilat është shprehur me vendim, si dhe për mënyrën se si zbatohen këto vendime. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqinë e ligjit dhe janë detyruese.</p> | E plotë | Nuk ka |
|----|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|

| | | | | | | |
|----|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|
| 5. | 21.05.2024 | <p>Kërkesë për informacion për çështjen me objekt <i>“Kërkesë për pezullim pjesor të Ligjit nr. 29/2023 dhe shfuqizimin e disa neneve të tij e akteve nënligjore”</i>, më konkretisht në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, statusin e saj procedural në momentin që i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, vendimarrjet e ndërmjetme në rast se ka dhe caktimin e datës për zhvillimin e seancës.</p> | 21.05.2024 | <p>Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar me email-in e datës 21.05.2024, si dhe në bazë të informacionit të dhënë nga Drejtoria Gjyqësore dhe Dokumentacionit, ju informojmë se:</p> <p>Në datën 24.04.2024, në Gjykatën Kushtetuese është plotësuar dhe regjistruar kërkesa e paraqitur nga shoqata e Sipërmarrësve Italianë në Shqipëri – A.I.I.A.(OJQ), Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, si dhe një grup profesionistësh të lirë, me objekt: <i>“Pezullimin e efekteve të nenit 12, pika 1, nenit 24, pika 2, nenit 69, pika 1, shkronja “dh” dhe shkronja “ë” të ligjit nr. 29/2023 dhe nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi. 2. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 12, pika 1, nenit 24, pika 2 dhe nenit 69, pika 1, shkronja “dh” dhe shkronja “ë” të</i></p> | E plotë | Nuk ka |
|----|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|

| | | | | | | |
|-----------|-------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| | | | | <p><i>ligjit nr. 29/2023 dhe nenit 4 të vendimit nr. 753, datë 20.12.2023 të Këshillit të Ministrave”.</i></p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është në fazën e shqyrtimit paraprak nga kolegji i Gjykatës Kushtetuese. Kolegji do të marrë në shqyrtim paraprak kërkesën tuaj, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 8577/2000, për të cilën do të njoftoheni zyrtarisht në vijim sipas adresës se lënë në kërkesë nga ana juaj.</p> | | |
| 6. | 05.06.2024 | <p>Kërkesë për informacion në lidhje me zhvillimet për çështjen me objekt “<i>Kërkesë për pezullim pjesor të Ligjit nr. 29/2023 dhe shfuqizimin e disa neneve të tij e akteve nënligjore</i>”, të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese.</p> | 06.06.2024 | <p>Në vijim të komunikimit, ju informojmë se kërkesa juaj është ende në fazën e shqyrtimit paraprak nga kolegji i Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>Kolegji do të marrë në shqyrtim paraprak kërkesën tuaj, sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 8577/2000, dhe ju do të njoftoheni zyrtarisht në vijim sipas adresës se lënë në kërkesë nga ana juaj.</p> | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|----|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|
| 7. | 20.10.2024 | Kërkesë për informim në lidhje me qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesën e avokateve të ish-kryeministrit Sali Berisha për përjashtimin e gjyqtares Marsida Xhaferllari nga shqyrtimi i çështjes se tij. | 24.10.2024 | Në përgjigje të emailit të mëposhtëm dhe kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se kërkesa e depozituar në datën 18.10.2024, për përjashtimin e gjyqtares Marsida Xhaferllari nga shqyrtimi i çështjes nr. 12 (S) 2024 Regj.Them., datë 29.07.2024, me kërkues Sali Berisha dhe objekt “ <i>Shfuqizimin e vendimeve nr. 112, datë 20.10.2023 dhe nr. 117, datë 26.10.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-384, datë 05.03.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.</i> ”, nuk është marrë ende në shqyrtim nga trupa gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese. | E plotë | Nuk ka |
|----|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------|

| | | | | | | |
|-----------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|---------------|
| | | | | | | |
| 8. | 03.10.2024 | <p>Kërkesë për informacion në lidhje me pamundësinë e Kuvendit për dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmerinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, pas abstenimit në shumicë nga ana e deputeteve të PS-së, më konkretisht nëse ka paqartësi se kush prevalon detyrimi i zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese apo vullneti i shprehur nga çdo deputet i Kuvendit?</p> | 06.12.2024 | <p>Në vijim të kërkesës suaj për informacion, pasi shqyrtuam me vëmendje kategoritë e informacionit të kërkuara nga ana juaj, si dhe në zbatim të nenit 1, pika 1, të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i cili parashikon se: “Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”, rezulton se informacioni i kërkuar nga ana juaj nuk plotëson kriteret e këtij ligji.</p> <p>Po ashtu, ju kujtojmë se çdo interpretim ligjor jashtë procesit që zhvillohet në gjykimin kushtetues është jashtë kompetencës dhe fushës së veprimit të Gjykatës Kushtetuese.</p> | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|----|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|
| | | | | Në vijim, dëshirojmë t'ju sjellim në vëmendje se në nenet 72, pika 7 dhe 76, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, parashikohet se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. | | |
| 9. | 22.11.2024 | <p>Kërkesë për koment/informacion mbi procesin e rifreskimit të Gjykatës Kushtetuese, në përputhje me nenin 179, pika 3 të Republikës së Shqipërisë dhe me opinionin e Komisionit të Venecias të qershorit 2020.</p> <p>Më konkretisht:</p> <p>Kush janë gjyqtarët të cilët duhet t'i nënshtrohen rregullit të ripërtëritjes në përputhje</p> | | Pa përgjigje | | |

| | | | | | |
|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|--|
| | <p>me nenin 179/3 të Kushtetutës?</p> <p>Kur do të përfundonte mandati i gjyqtares Elsa Toska nëse ajo nuk do të ishte dorëhequr?</p> <p>Në çfarë date ishte përlogaritur të shprehej Gjykata me vendim për këtë çështje?</p> <p>Kur mbaron mandati i gjyqtares Sonila Bejtja?</p> <p>Kur mbaron mandati i kryetares së Gjykatës, znj. Holta Zaçaj?</p> <p>Kur do të marrë një vendim gjykata për këto 3 rifreskime në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”?</p> <p>Sa e rëndësishme është sipas institucionit tuaj, ripërtëritja e Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 179, pika 3 të Republikës së Shqipërisë dhe me opinionin e Komisionit të Venecias të qershorit 2020?</p> | | | | |
|--|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|--|--|--|

| | | | | | | |
|------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--|---------------------|--|--|
| | | | | | | |
| 10. | 10.12.2024 | <p>Kërkesë për koment/informacion me objekt çështjen e deputetes Olta Xhaçka, për të cilën Kuvendi dhe politika ka në dorë një Opinion të Komisionit të Venecias, nëse ka hapësirë dhe a do ta marrë vetë Gjykata Kushtetuese në shqyrtim çështjen e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes së PS-së, Olta Xhaçka, pa e sjellë Kuvendi i Shqipërisë?</p> | | Pa përgjigje | | |